



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

Nr. 1962/2 Prot.

Tiranë, më 11.10.2022

V E N D I M

Nr. 22/ datë. 11.10.2022

PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË Z. EUGEN NASUFI NË VENDIN VAKANT PËR INSPEKTOR JO MAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NË DATËN 30.09.2021.

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i përbërë nga:

Z. Besnik Maho - Kryetar
Znj. Joana Asimi – Anëtar
Z. Julian Zonja - Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik i përbërë nga:

Znj. Alma Zili
Znj. Eljona Bylykbashi
Znj. Jetmira Saraçi

Në mbledhjen e datës 10.10.2022, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidatit inspektor jomagjistrat

Z. EUGEN NASUFI

OBJEKTI:

Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së z. Eugen Nasufi në vendin vakant për Inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021.

KOMITETI PASI:

U njoh me aktet si edhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me njoftimin e datës 30.09.2021, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 9 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.
2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 142, datë 29.10.2021 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim datë 29.10.2021, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 08.11.2021, ku vendosi për radhën e shqyrtimit të dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave/zhvillimit të procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke njoftuar në faqen zyrtare në rubrikën "Njoftime"; "Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë" listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të

kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”.

4. Në zbatim të nenit 209 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të pikës 27, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komiteti i Emërimeve dhe Vlerësimit të Inspektorëve, pasi zhvilloi procedurat e verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore për pozicionin e inspektorit, në mbledhjen e datës 07.07.2022, vendosi lejimin e kandidimit për pozicionin e inspektorit jomagjistrat për z. Eugen Nasufi dhe me komunikimin e datës 14.09.2022, njoftoi kandidatët për fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve.
5. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve me vendimin nr.22, datë 07.07.2022 ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatit Eugen Nasufi për Inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 209 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke u bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e kandidimit dhe gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, hartoi relacionin e vlerësimit të këtij kandidati.
6. Sipas kalendarit të intervistave të miratuar, në 21.09.2022 dhe 22.09.2022, ka zhvilluar procedurën e intervistës me kandidatët e lejuar, mbi motivimin e kandidimit, për 9 (nëntë) vendet vakante.
7. Intervista mbi motivimin e kandidimit, z. Eugen Nasufi, kandidati për të 9 (nëntë) vendet vakante në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, u zhvillua në datën 22.09.2022.

II. Vlerësimi i Komitetit

8. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidimit, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej tij sipas kërkesave të Komitetit, si edhe shkresa dhe të dhëna të tjera kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Komiteti ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit Eugen Nasufi për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara në shpjegimet e hollësishme të metodologjisë mbi të cilën bazohet vlerësimi dhe pikëzimi, miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përkatësisht:

1. Meritat profesionale - (50) pikë

A. Historiku Arsimor dhe Profesional - (10) pikë

9. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Eugen Nasufi, disponon këto të dhëna:

- Jurist, Këshilli i Rrethit Dibër, 16 Shtator 1996-20 Mars 1998;
- Jurist, pranë Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Dibër për periudhën 20 Mars 1998-31 Dhjetor 2001;
- Oficer aktiv, Jurist, Shërbimi Informativ Shtetëror për periudhën 05 prill 2005- 01 Nëntor 2005;
- Konsulent ligjor, Shoqata Aksion Plus për periudhën 01 Qershor 2003-04 Prill 2005;
- Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë për periudhën 01 Nëntor 2005-18 Shtator 2011;
- Përgjegjës i Sektorit të Personelit, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Qytetit Tiranë, për periudhën 23 Shtator 2011- 31 Dhjetor 2011;
- Drejtor Drejtorie Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Qytetit Tiranë për periudhën 01 Janar 2012- 17 Gusht 2015;
- Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, për periudhën 01 Dhjetor 2015-21 Gusht 2020;
- Ndhmës Inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 21 Gusht 2020- deri në datën e paraqitjes së aplikimit.

a. Historiku arsimor - (2) pikë

10. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes

së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së **arsimit të lartë juridik** me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, ndërkohë që edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.

11. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Eugen Nasufi;

- Ka përfunduar Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në periudhën 1996, duke u diplomuar “*Jurist*”. Sipas certifikatës së notave të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, rezulton se ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare 8.1.

12. Prandaj, Komiteti vlerëson me pikë ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, secilin kandidat, sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve.

13. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “historiku arsimor”, nisur nga nota mesatare 8.1, e arritur gjatë studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Komitetit çmoi ta vlerësojë kandidatin **Eugen Nasufi** me **1 (një) pikë**.

b. Kualifikime Pasuniversitare - (5) pikë

b.1 Studimet pasuniversitare - (1/5) pikë

14. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe mbajtja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.

15. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Eugen Nasufi të këtë ndjekur studime pasuniversitare, Master i Nivelit të Dytë

(Master ekzekutiv) në Shkenca Juridike me profil “ E drejtë Biznesi”, Universiteti “Marin Barleti”.

16. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Kualifikim pasuniversitar lloji Master**”. Në total, për këtë kriter vlerësimi kandidati Eugen Nasufi vlerësohet me **1 (një) pikë.**

b.2 Gradat shkencore - (3/5) pikë

17. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe mbajtja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.
18. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve, si edhe orientimet që përmbahen në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për inspektor jomagjistrat.
19. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, nuk rezulton që kandidati Eugen Nasufi të këtë fituar brenda ose jashtë vendit grada shkencore në bazë të të nenit 60-61 dhe 79 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, (Dr, Phd, Prof apo Pro/asoc, Magjistraturë, etj).
20. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Kualifikime Pasuniversitare**”, që lidhet me gradat dhe kërkimin shkencor, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin Eugen Nasufi me **0 (zero) pikë.**

b.3. Lista dhe lloji i trajnimeve - (1/5) pikë

21. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Eugen Nasufi ka ndjekur disa veprimtari trajnimi afatshkurtra të dokumentuara, konkretisht:

- Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bashkëpunim me (OPDAT). Në datë 27.05.2021 vijoi sesionin e trajnimeve në funksion të fuqizimit të kapaciteteve të ILD-së, për hetimin disiplinor të magistratëve dhe për përmirësimin e procesit të pranimit, shqyrtimit dhe veprimit, në bazë të akuzave për sjellje të papërshtatshme nga magistratët, që ushtrojnë detyrat në institucionet e reja të drejtësisë në Shqipëri.
- Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bashkëpunim me misionin EURALIUS në datë 27.05.2021 organizuan një trajnim me administratën e ILD-së, mbi hetimin disiplinor në Shqipëri. Një vështrim i përgjithshëm i sistemit disiplinor në Shqipëri dhe roli i administratës së ILD-së, ishte në fokus të trajnimit një ditor. Trajnimi u zhvillua në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bashkëpunim me (OPDAT). Në datë 22.04.2021, organizoi një trajnim me temë: Fuqizimi i sistemit gjyqësor shqiptar :Vlerësimi i sjelljes së papërshtatshme. Qëllimi: Përmirësimi i procesit të pranimit, shqyrtimit dhe veprimit në bazë të akuzave për sjelljen të papërshtatshme nga magistratët që ushtrojnë detyrat në institucionet e reja të drejtësisë në Shqipëri të krijuara si rezultat i reformës në drejtësi si dhe shërbimi si një forum për shkëmbimin e ideve dhe praktikave më të mira për adresimin e çështjeve të përbashkëta. Trajnimi u zhvillua online në ZOOM Government.
- Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bashkëpunim me misionin EURALIUS, në datë 16.04.2021, cikli i katërt të trajnimit mbi hetimin disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. U trajtuan specifika të punës përgatitore përpara fillimit të një hetimi disiplinor, interpretime të ligjit, sjellja e magistratit, si dhe zbatimi i dispozitave kushtetuese gjatë periudhës tranzitore për shkak të vakumit ligjor.
- Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bashkëpunim me ekspertë të misionit EURALIUS në datë 03.03.2021, trajnim 1 ditor mbi sistemin disiplinor në një këndvështrim të përgjithshëm. Gjatë trajnimit u trajtuan çështje të kuadrit të ri ligjor mbi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve e prokurorëve dhe përputhshmërinë e sistemit të ri disiplinor me standardet ndërkombëtare.
- Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bashkëpunim me ekspertët të Bashkimit Evropian TAIEX, në datë 25.02.2021, trajnim online me fokus çështjet disiplinore të magistratëve dhe zbatimi i legjislacionit në shtete të caktuara të Bashkimit Evropian, e posaçërisht në një vend si Spanja, mbi organizimin dhe funksionimin e institucioneve të autorizuara për të kryer hetimet dhe procedimet disiplinore ndaj magistratëve, çështjet disiplinore të magistratëve (gjyqtarëve dhe prokurorëve), metodologjitë dhe standardet ndërkombëtare për hetimin dhe procedimin disiplinor nga institucionet e këtij shteti,

përputhshmëria me kuadrin ligjor të BE-së dhe jurisprudenca mbi shkeljet disiplinore të magjistratëve.

- **Periudha: Tetor 2019**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Menaxhimi i burimeve njerëzore
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA)

- **Periudha: Shkurt 2017**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Etika, vlerat dhe disiplina në administratën publike
Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA)

22. Duke pasur parasysh numrin, llojin, kohëzgjatjen dhe tematikat e veprimtarive trajnuese të ndjekura nga kandidati **Eugen Nasufi**, për këtë kriter ligjor vlerësimi Komiteti çmoi ta vlerësojë me **1 (një) pikë**.

c. Njohja e gjuhëve të huaja - (3) pikë

23. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati ka vetëdeklaruar në jetëshkrim se është njohës i gjuhës angleze, e dëshmuar kjo nga certifikata e lëshuar nga Qendra Linkoln.
24. Për këto arsye, duke pasur parasysh dokumentacionin e administruar, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin Eugen Nasufi për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **1 (një) pikë**.

B. Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional - (30) pikë

25. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrorit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe kualifikimi i **përgjithshëm profesional**, përcaktohen si kriteret vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.
26. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen

parasysh sasia e pikëve maksimale **prej 30 pikësh** sipas urdhrit nr. 7 referuar si më sipër, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të **një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin** dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor Jomagjistrat.

27. Në rastin e kandidatit Eugen Nasufi, Komiteti shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e tij profesionale ndër vite, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të këtij kandidati në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.

a. Vlerësimi sasior - (5) pikë

28. Për sa i përket **vlerësimit sasior**, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, rezulton se në dosjen e kandidimit është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm që ka të bëjë me aktivitetin profesional, kërkimin shkencor dhe publikimet nga ana e kandidatit z. Eugen Nasufi:

- Projektvendim nr. ____ prot., datë ____/____/2020 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës të paraqitur nga ankuesi Kryegjyshata Botërore Bektashiane” (6 faqe);
- Projektvendim nr. ____ prot., datë ____/____/2021 “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës të paraqitur nga shtetasja D.Z” (6 faqe);
- Projektvendim nr. ____ prot., datë ____/____/2021 “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës të paraqitur nga subjekti Konstruksion shpk”(7 faqe);
- Projektvendim nr. ____ prot., datë ____/____/2021 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës të shtetasit A.H” (6 faqe);
- Relacion nr. ____ prot., datë ____/____/2021 “Për praktikën e përcjellë nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me hetimin disiplinor ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit Hektor Sinanaj, gjyqtar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Vlorë (8 faqe);
- MEMO nr. 768/9 prot., datë 30.12.202, drejtuar Inspektorit të lartë të Drejtësisë, me propozimin për arkivimin pas verifikimit të ankesës të paraqitur nga subjekti “Shërbimi Përmbarrimor ZIG” shpk; (5 faqe);
- Relacion nr. ____ prot., datë ____/____/2021 “Për verifikimin lidhur me ankesën e paraqitur nga shtetasi N.P. (5 faqe).

29. Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës apo edhe me ushtrimin e profesionit, Komiteti vlerëson se në aspektin sasior kandidati Eugen Nasufi ka tregues të lartë angazhimi profesional, i cili rezulton të jetë dukshëm përtej asaj që mund të gjykohet si një

angazhim i zakonshëm apo “mesatar” në ushtrimin e profesionit. Për këto arsye, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin Eugen Nasufi për këtë kriter ligjor vlerësimi me 5 (pesë) pikë.

b. Vlerësim cilësor - (25) pikë

30. Për sa i përket **vlerësimit cilësor**, Komiteti shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionale dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e tij në kuptimin dhe qëllimin për të cilin ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Komitet dhe, më tej, për përzgjedhjen e Inspektorit jomagjistrat.
31. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, kandidati **Eugen Nasufi**, në funksionet e ndihmës inspektorit në ILD, ka paraqitur para Komitetit për qëllimet e procedurës së vlerësimit në kuadër të pikëzimit për “Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional” dhe “Kualifikimin Shtesë Profesional”, shtatë dokumentet profesionale nga të cilat nga Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve janë përzgjedhur nga si më poshtë:
- Projektvendim nr. ____ prot., datë ____/____/2020 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës të paraqitur nga ankuesi Kryegjyshata Botërore Bektashiane” (6 faqe). Në këtë vendim kandidati z. Eugen Nasufi ka përgatitur sipas kritereve formale dhe ligjore vendimin në lidhje me trajtimin e një ankesë ku në bazë të nenit 121, pika 2 shkronja a), të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ku është propozuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, arkivimi e ankesës pas shqyrtimit fillestar, për arsye se fakti që përbën shkelje disiplinore nuk ekziston si dhe nuk ka elementë provueshmërie se është kryer shkelja disiplinore e pretenduar, duke mos u plotësuar kushti për pranueshmi i parashikuar nga neni 120, pika 1 shkronja d) dhe dh) e ligjit nr.966/2016 “Për Statusin”, ndryshuar
 - Projektvendim nr. ____ prot., datë ____/____/2021 “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës të paraqitur nga shtetasja D.Z” (6 faqe); Në këtë vendim kandidati z. Eugen Nasufi ka përgatitur sipas kritereve formale dhe ligjore vendimin në lidhje me trajtimin e një ankesë ku në bazë të nenit 122/4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 204, pika 1, shkronja j) dhe neni 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ku është propozuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, arkivimin pas verifikimit të ankesës, për arsye se pretendimet e ankueses nuk janë të natyrës që përbejnë shkelje

disiplinor sipas përcaktimeve të neni 102, pika 1 shkronja gj) e ligjit nr.966/2016 “Për Statusin”, ndryshuar.

- Projektvendim nr. ____ prot., datë ____/____/2021 “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës të paraqitur nga subjekti Konstruksion shpk”(7 faqe). Në këtë vendim kandidati z. Eugen Nasufi ka përgatitur sipas kritereve formale dhe ligjore vendimin në lidhje me trajtimin e një ankesë ku në bazë të nenit 117 dhe 122/4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ku është propozuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, arkivimin pas verifikimit të ankesës, për arsye se mungojnë dyshime të arsyeshme që justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor.
- Projektvendim nr. ____ prot., datë ____/____/2021 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës të shtetasit A.H” (6 faqe); Në këtë vendim kandidati z. Eugen Nasufi ka përgatitur sipas kritereve formale dhe ligjore vendimin në lidhje me trajtimin e një ankesë ku në bazë të nenit 121, pika 2 shkronja a), të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ku është propozur Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, arkivimi e ankesës pas shqyrtimit fillestar, për arsye se fakti që përbën shkelje disiplinore nuk ekziston si dhe nuk ka elementë provueshmërie se është kryer shkelja disiplinore e pretenduar, duke mos u plotësuar kushti për pranueshmi i parashikuar nga neni 120, pika 1 shkronja d) dhe dh) e ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar;
- Memo nr. 768/9 prot., datë 30.12.202, drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me propozimin për arkivimin pas verifikimit të ankesës të paraqitur nga subjekti “Shërbimi Përmbarrimor ZIG” shpk; (5 faqe); Në këtë memo kandidati z. Eugen Nasufi ka përgatitur sipas kritereve formale dhe ligjore vendimin në lidhje me trajtimin e një ankesë në lidhje me trajtimin e një ankesë ku në bazë të nenit 122/4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ku është propozuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, arkivimi e ankesës pas verifikimit, për arsye se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit disiplinor.

32. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati **Eugen Nasufi** dhe, në veçanti, lidhur me pesë dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Komiteti shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë orientime që përmbahen në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor.(shtojca nr.2).

33. Dokumentet trajtojnë tematika në fushën e së drejtës në të cilën kandidati, ka operuar si ndihmësinsektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të cilat përfshijnë objektin e veprimtarisë së ILD si autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.
34. Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati z. Eugen Nasufi, për sa më sipër si dhe intervista e zhvilluara me të nga ana e Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, vlerësimi i këtyre të dhënave bëhet në pesë komponentë kryesorë që janë, origjinaliteti dhe/ose impakti i veprimtarisë profesionale të kandidatit, aftësitë analitike, aftësitë kërkimore, saktësia dhe precizoni, si dhe qartësia.

b/1. Origjinalitet dhe/ose impakti - (6) pikë

35. Njëri nga indikatorët vlerësues të dokumenteve profesional është vlerësues të dokumenteve profesionalë është “**Origjinaliteti dhe/ose impakti**”. Nisur nga profili profesional i kandidatit Eugen Nasufi, përmbajtja e dokumenteve të analizuara dhe dobisë së tyre nga profesionistë të fushës apo grupeve të interesit, Komiteti vëren se dokumentacioni i paraqitur ofron një panoramë të elementëve të një qasje profesionale origjinale në trajtimin e çështjeve ligjore nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për rrjedhojë krahas disa elementëve të origjinalitetit në përmbushjen e detyrës për aq sa e lejon natyra e funksionit të ushtruar duke i ofruar ndihmë inspektorit në përmbushjen e detyrave ligjore nëpërmjet hartimit të dokumenteve përgatitore gjatë fazës së shqyrtimit fillestar, verifikimit dhe hetimit disiplinor rreth shkeljeve të pretenduara disiplinore të subjekteve të parashikuara në ligj, duke mbledh të dhëna dhe vlerësuar çdo informacioni ose akte në përputhje me ligjin duke sjellë argumente në dobi të punës në ILD.
36. Për rrjedhojë pas shqyrtimit të dokumentacionit, në zërin “**Origjinaliteti dhe impakti**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **5 (pesë) pikë**.

b/2. Aftësitë analitike - (6) pikë

37. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me “**Aftësitë analitike**”, Komiteti duke u përqendruar në projektvendimet dhe në memo-n drejtuar ILD arrin në konkluzionin se draftet e projektvendimeve të hartuara dhe memo tregojnë dhe dëshmojnë zotërimin e aftësisë profesionale të kandidatit për të arsyetuar dhe zbatuar konceptet ligjore në fushën e operimit.
38. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit të analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me zërin “**Aftësitë analitike**”, Komiteti vlerëson kandidatin me **5 (pesë) pikë**.

b/3. Aftësitë kërkimore - (4) pikë

39. Në lidhje me treguesin “**Aftësitë kërkimore**”, Komiteti shqyrtoi dokumentacionin profesional të paraqitur nga kandidati. Nga ky shqyrtim Komiteti vëren se këto punime përmbajnë informacione të larmishme profesionale, të përdorura dhe të lidhura efektivisht me natyrën, qëllimin dhe përmbajtjen e secilit prej punimeve të shqyrtuara, të nxjerra nga praktika gjyqësore vendase.
40. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “Aftësitë kërkimore”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

b/4. Saktësia dhe precizioni - (5) pikë

41. Referuar kriterit “**Saktësia dhe precizioni**”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët kanë mbuluar me profesionalizëm tematikën e përzgjedhur duke shmangur përsëritjet në material. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, për aq sa është e mundur nga lloji i dokumentacionit, Komiteti vëren se këto punime tregojnë nivel të lartë të përcaktimit të tematikës dhe problemeve juridike nivel të mjaftueshëm të përcaktimit të tematikës dhe problemeve juridike për analizë dhe zgjidhje, përdorim të pasur dhe korrekt të terminologjisë juridike dhe strukturim e përdorim në mënyrën dhe vendin e duhur të gjetjeve nga legjislacioni si edhe praktika gjyqësore shqiptare.
42. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “**Saktësia dhe precizioni**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **4 (katër) pikë**.

b/5. Qartësia - (4) pikë

43. Referuar kriterit “**Qartësia**”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët e kanë strukturuar tematikën dhe problemin duke qartësuar gjuhën dhe duke përdorur në mënyrë të kënaqshme terminologjinë profesionale. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, për aq sa është e mundur nga lloji i dokumentacionit, Komiteti vëren se pasuria, qartësia e gjuhës së përdorur dhe organizimi i duhur i materialit i bëjnë këto punime kuptueshme dhe të lexueshme, sipas grupeve të interesit të cilave synon ti drejtohet.
44. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “**Qartësia**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **4 (katër) pikë**.

45. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, që përbëjnë **vlerësimin cilësor** të kandidatit, Komiteti vendosi të vlerësojë kandidatin me **21 (njëzeteni) pikë**.

C. Kualifikim shtesë profesional - (10) pikë

a. Përvoja dhe cilësia profesionale e posaçme për rolin dhe funksionet e inspektorit pranë ILD-së - (7) pikë

46. Rezultatet profesionale në lidhje me këtë kriter vlerësimi, shqyrtohen nga Komiteti për të vlerësuar veçanërisht rëndësinë dhe dobinë e profilizimit dhe specializimit të arritur në përvojat e veçanta profesionale të kandidatit të cilat tregojnë vlera të spikatura profesionale në shërbim të drejtimit, organizimit dhe funksionimit të inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe të ushtrimit të kompetencave të këtij institucioni. përfshirë këtu vlerësimin e njohurive të posaçme profesionale në lidhje me ushtrimin e kompetencave të kontrollit. inspektiveve, hetimeve disiplinore si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji.
47. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 10 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Komiteti, vlerëson deri në **7 pikë** ekspertizën në fushat e së drejtës dhe posaçërisht në çështjet e drejtimit, organizimit dhe funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si dhe ushtrimit të kompetencave me natyrë kontrolli, inspektimi, hetimi disiplinor si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji. Gjithashtu, Komiteti vlerëson deri në 3 pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidateve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Komiteti mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara urdhrin nr. 7 (si më sipër) të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve.
48. Në rastin e kandidatit, Komiteti shqyrtoi dokumentet profesionale, të dhënat e jetëshkrimit, si dhe u bazua në intervistën e zhvilluar dhe motivimin për kandidim, ku rezultoi se kandidati ka përvojë në fushën e inspektiveve, në cilësinë e ndihmësit ligjor pranë ILD, duke vlerësuar kohëzgjatjen e këtij angazhimi të posaçëm të kandidatit.
49. Për këtë arsye, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve për kriterin vlerësues të “Përvoja dhe cilësia profesionale e posaçme për rolin dhe funksionet e inspektorit pranë ILD-së”, e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

a. Angazhime profesionale shtesë - (3) pikë

50. Nga aktet e dosjes dhe nga vetëdeklarimet e kandidatit Eugen Nasufi, rezulton se ka paraqitur dokumente të angazhime shtesë profesionale, krahas atyre që janë përmendur në këtë vendim, sikurse është zotërimi i licencës të ushtrimit të profesionit të “Avokatit”.

Periudha: Viti 2007

Lloji i titullit/ fusha profesionale: Licencë për ushtrimin e profesionit të avokatit pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Tiranë; (Nr. Licence 3246, datë 31.03.2007).

Emri dhe lloji i institucionit që ka dhënë titullin: Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Adresa dhe kontaktet e institucionit: Rruga “Murat Toptani”, Qendra e Biznesit “Eurocol”, kati 9, Tiranë.

51. Për këtë arsye Komiteti i emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve për kriterin vlerësues të “Angazhimeve profesionale shtesë”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **1 (një) pikë**.

52. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë merita profesionale dhe kualifikim shtesë profesional, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **4 (katër) pikë**.

2. MERITA MORALE, ORGANIZATIVE, DREJTUESE DHE MENAXHERIALE - (50) pikë

2/1. Merita morale - (25) pikë

53. Si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për integritet të lartë moral dhe profesional. Konkretisht përcaktohen si kriterë vlerësimi edhe "*Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegeve*" dhe “cilësi morale të tilla si: Ndershmëria, përpikëria, drejtësia në marrjen e vendimeve dhe ushtrimin e detyrave” si edhe "angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”.

54. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 25 pikësh për të tre komponentët vlerësues, Komiteti vlerëson deri në 15 pikë integritetin etik dhe moral, deri në 8 pikë reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegeve dhe deri në 2 pikë angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

55. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 25 pikësh për të tre komponentët vlerësues, Komiteti vlerëson deri në 15 pikë integritetin etik dhe moral, deri në 8 pikë reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegeve dhe deri në 2 pikë angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

56. Në rastin e kandidatit, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes parashtrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Komitetin gjatë

procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës. Komiteti shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave morale të këtij kandidati.

a. Integriteti etik e moral - (15) pikë

57. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, integritetit etik e moral, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij tregon përkushtim dhe angazhim të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave profesionale dhe në ushtrimin e profesionit, si edhe vëmendje, ndjeshmëri dhe respekt në komunikim e bisedë, duke parashtruar argumentet e tij me kompetencë, dinjitet, duke dëgjuar dhe përgjigjur me kujdesin e duhur, me durim e vetëpërbajtje përkundrejt qëndrimeve dhe pyetjeve të cilat i drejtohen nga bashkëbiseduesit.
58. Nga të dhënat e mundshme në dispozicion, Komitetit nuk i rezulton që kandidati të ushtrojë apo të ketë ushtuar funksionet e tij profesionale duke favorizuar palë të caktuara apo duke kërkuar përfitime për veten apo për të tjerët. Nuk rezultojnë të dhëna që ky kandidat të mos ketë respektuar detyrimin profesional të nderit dhe të dinjitetit, të ndërtimit të marrëdhënieve profesionale dhe mirësjelljes në raport me kolegët, profesionistët e fushës, palët e përfshira në çështje pune etj. Pra nuk ka të dhëna që me sjelljen dhe veprimtarinë e tij në jetën profesionale dhe personale të ketë cenuar apo të rrezikojë të cenojë imazhin dhe figurën publike të nëpunësit shtetëror dhe sistemit të drejtësisë.
59. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "*integritetit etik e moral*", Komiteti e vlerëson kandidatin me **15 (pesëmbëdhjetë) pikë**.

b. Reputacioni në shoqëri dhe midis kolegëve - (8) pikë

60. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve", nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim. Intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati me veprimtarinë dhe sjelljen në shoqëri, tregon angazhim dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave për zbatimin e drejtë të ligjit në ushtrimin e kompetencave që i ngarkon ligji.

61. Sipas të dhënave që disponohen Komiteti vëren se kandidati Eugen Nasufi ka përmbushur me korrektesë detyrimet profesionale duke i ushtruar me seriozitet, maturi dhe besnikëri funksionet e ndryshme gjatë karrierës profesionale. Në lidhje me vlerësimin e punës dhe reputacionin që kandidati z. Eugen Nasufi, rezulton se pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kandidati ka dorëzuar vlerësime (rekomandime) nga punëdhënësit e mëparshëm dhe aktual, për të evidentuar reputacionin që ai gëzon si dhe cilësitë etiko-profesionale për sa i përket marrëdhënieve të punës, sikurse janë vlerësimet e punës të vitit 2020, lëshuar nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe vlerësim pune 21.08.2020 – 30.06.2021, për periudhën si ndihmësinjektor, në lidhje me përmbushjen e detyrave që e ngarkon ligji.
62. Prandaj, duke konstatuar se me sjelljen dhe veprimtarinë e tij përmbush të gjitha pritshmëritë e aspektit moral për marrjen e përgjegjësisë ligjore dhe institucionale, si edhe pritshmërinë e publikut për gëzimin e cilësive profesionale e morale për ushtrimin e detyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me kriterin vlerësues “të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **7 (shtatë) pikë.**

c. Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile - (2) pikë

63. Për sa i përket kriterit të vlerësimit që lidhet me angazhimin në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se, përgjithësisht, kandidati nuk ka qenë i angazhuar në veprimtari të tjera të përshtatshme jashtë atyre të lidhura me ushtrimin e detyrës ose të profesionit për ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.
64. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “**Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **0 (zero) pikë.**
65. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë e meritave morale, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **22(njëzetedy) pikë.**

2/2 Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale - (25) pikë

66. Ky komponent zërthehet në disa nën komponentë të tjerë, konkretisht:
- a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin;
 - b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
 - c) aftësitë e komunikimit;
 - d) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;

dh) aftësitë e përfaqësimit publik."

67. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kritere vlerësimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" ku përcaktohen rregullime me të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kriterëve.
68. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 25 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Komiteti vlerëson deri në 8 pikë cilësinë e platformës dhe vizionin që paraqesin kandidatët, deri në 10 pikë aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore, deri në 5 pikë aftësisë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik, si edhe me 2 pikë për aftësitë e të punuarit në grup dhe ambiente multidisiplinore.
69. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij, Komiteti mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" dhe Shtojcën nr. 2 të tij si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituarra sipas metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për inspektor.
70. Komiteti shqyrtoi përmbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës dhe arsyet apo motivet e kandidimit dhe vizionit të kandidatit lidhur me qasjen dhe qëndrimet e tij mbi rëndësinë dhe aspektet thelbësore të ushtrimit të detyrës së Inspektorit, mbi sfidat kryesore me të cilat duhet të përballlet Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ushtrimin e përgjegjësive dhe kompetencave që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji, si edhe lidhur me mendimet e kandidatit për çështjet që duhet të trajtohen me përparësi e në perspektivë për mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e këtij institucioni të ri dhe shumë të rëndësishëm kushtetues, për ushtrimin efektiv dhe me nivel të lartë profesional e besueshmërie të kompetencave të tij në funksion të ndërtimit të një sistemi drejtësie të bazuar në integritetin profesional e moral, nisur edhe nga pritshmëritë e jashtëzakonshme të publikut pas miratimit dhe vënies në zbatim të reformës në drejtësi. Gjithashtu, në vlerësimin e këtij kriteri, Komiteti mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga ky kandidat gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që iu drejtuan nga anëtarët e Komitetit.

a. Cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqet kandidati - (8) pikë

71. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Komiteti vëren se kandidati paraqiti një nivel mbi mesatar të njohjes dhe përvojës profesionale së saj në lidhje me rolin dhe pritshmëritë për ushtrimin e funksionit të inspektorit jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe elemente premtues që tregojnë cilësi, thellësi dhe originalitet për sa i përket sfidave me të cilat do të përballet kandidati, objektivat për çështjet e organizimit dhe funksionimit cilësor dhe efektiv të institucionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke vënë theksin të pavarësia e tij, respektimi i procesit të rregullt ligjor, zhvillimi i marrëdhënieve me publikun.
72. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “Cilësia e platformës dhe vizionit të paraqitur” nga kandidatet, Komiteti e vlerëson kandidatin me **6 (gjashtë) pikë.**

b. Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, bazuar në përvojat e mëparshme profesionale shoqërore - (10) pikë

73. Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, Komiteti mbështetet pikësepari në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidatëve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsipër të përgjegjësi dhe ushtrimin e vendimmarrjes në përmbushjen e kompetencave dhe të detyrave të ngarkuara, veçanërisht për aspektet e drejtimit dhe të administrimit të punëve. Në këtë drejtim, Komiteti shqyrton dhe vlerëson posaçërisht aftësitë e provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësi si edhe për të marrë vendimet e duhura e në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.
74. Në rastin e kandidatit, krahas jetëshkrimit, parashtrimeve dhe bisedës në interviste, përmbajtjes së platformës dhe motivimit për kandidim, Komiteti shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit. Për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara apo premtuese të këtij kandidati për të marrë vendime dhe përgjegjësi edhe në ushtrimin e funksionit të inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
75. Komiteti vëren se kandidati Eugen Nasufi në karrierën e tij profesionale ka ushtruar për periudhën 01 Nëntor 2005-18 Shtator 2011 funksionin e Përgjegjës të Sektorit Juridik dhe Prokurimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë; për periudhën 23 Shtator 2011- 31 Dhjetor 2011 funksionin e Përgjegjës të Sektorit të Personelit, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Qytetit Tiranë, për periudhën 01 Janar 2012- 17 Gusht 2015 funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1, e Qytetit Tiranë; për periudhën 01 Dhjetor 2015-21 Gusht 2020 funksionin e Përgjegjës të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, funksione të cilat kërkojnë dhe dëshmojnë zotërimin dhe ushtrimin efektiv të vendimmarrjes në përmbushjen e

detyrave që i ka ngarkuar ligji, përfshirë dhe ato të lidhura me aspektet e administrimit dhe ushtrimit të institucioneve dhe njësive përkatëse të administratës shtetërore.

76. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **8 (tetë) pikë.**

c. Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik - (5) pikë

77. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, veçanërisht me nëpunësit dhe punonjësit e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me organet e tjera të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe përfaqësuesit e tyre, me gjyqtarët dhe prokurorët, sikurse edhe në komunikimin dhe përfaqësimin publik e me të tretët, të shprehurit në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jo diskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
78. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të platformës, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Komiteti vëren se kandidati zotëron aftësi të mjaftueshme/ aftësi komunikimi si rrjedhshmëria/konfidenca/ për të komunikuar me maturi, përgjigje koncize dhe nuk lë vend për paqartësi, për të komunikuar me maturi, për të dëgjuar me respekt dhe për t’u përgjigjur me profesionalizëm, qartësi e thjeshtësi, me stil dhe gjuhë të pasur në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen, ashtu edhe për çështje dhe problematika që ngrihen nga të tjerët.
79. Gjithashtu referuar prezantimit të bërë gjatë intervistës, rezulton se ky kandidat zotëron edhe aftësi të mira për përfaqësimin publik, prezanton thjeshtësi, aftësi për të shprehur bindjet e tij me vetëbesim. Kandidati transmeton besueshmëri gjatë komunikimit dhe aftësi për t’u përgjigjur me etikë. Kandidati zotëron edhe aftësi të mira për përfaqësimin publik.
80. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik", Komiteti e vlerëson kandidatin me **5 (pesë) pikë.**

d. Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore - (2) pikë

81. Inspektori për vetë natyrën e këtij institucioni dhe funksioni, duhet të zotërojë aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të organizuar dhe për të qenë i përfshirë në punën në grup, me nëpunësit dhe punonjës të Zyrës dhe për aq sa kërkohet dhe nevojitet me

funksonarë e përfaqësues të institucioneve të tjera dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevoja për t'u përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për t'u përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.

82. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Komiteti vëren se kandidati zotëron aftësitë e duhura për të punuar në grup, përfshirë atë për të punuar në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore.
83. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues "Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore", Komiteti vlerëson t'i caktojë kandidatit **2 (dy) pikë**.
84. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë e meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale, kandidati vlerësohet në total nga Komiteti me **21 (njëzetnjë) pikë**.

III - Vlerësimi përfundimtar i kandidatit

85. Në përfundim të arsytimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar me sipër në këtë vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së Inspektorit jomagjistrat dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për këtë vend vakant, Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i rezulton se kandidati Eugen Nasufi vlerësohet në total **77 (shtatëdhjeteshtatë) pikë**.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve:

V E N D O S I:

1. Vlerësimin e kandidatit Eugen Nasufi, me **77 (shtatëdhjeteshtatë) pikë**, në lidhje me kandidimin e tij për vendin vakant inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021.

2. Ky vendim i njoftohet kandidatit Eugen Nasufi.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në pjesën e përcaktuar për “Rekrutim Inspektor Jo magjistrat”.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

ANËTAR


Julian Zonja

KRYETAR

Besnik Maho



ANËTAR

Joana Asimi
